



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 656 Akti

Nr. 805 Vendimi  
Tiranë, më 7.10.2024

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	Kryesuese
<b>Pamela Qirko</b>	Relatore
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në datën 4.10.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Xhemal Saliaj**, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti pas kalimit të rezultateve të hetimit dhe dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

- i.** Subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
- ii.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, në datën 15.12.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, iu nënshtroi procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Xhensila Pine dhe Pamela Qirko (relatore). Trupi gjykues caktoi me mirëkuptim kryesuese znj. Alma Faskaj, si dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit për subjektin e rivlerësimit, z. Xhemal Saliq.
- iii.** Komisioni administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP).
- iv.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me provat për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 10.9.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Xhemal Saliq; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me dosjen; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- v.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 10.9.2024, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni, duke u njoftuar mbi afatin e sjelljes së provave dhe shpjegimeve, i cili u vendos deri në datën 25.9.2024.
- vi.** Në vijim, nëpërmjet postës elektronike me *email*-in e datës 23.9.2024, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e afatit për të paraqitur shpjegime/prova, për shkaqe shëndetësore, duke paraqitur në cilësinë e provës raportin për paaftësi në punë, me nr. regj. \*\*\*, datë 23.9.2024.
- vii.** Trupi gjykues, pasi administroi kërkesën, vendosi ta pranojë atë, duke i dhënë mundësi subjektit të paraqesë shpjegimet e tij deri në datën 30.9.2024.
- viii.** Me paraqitjen e shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti brenda afatit të caktuar dhe pas shqyrtimit të tyre, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, me *email*, në datën 1.10.2024.

## I. SEANCA DËGJIMORE

- ix.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 4.10.2024, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.
- x.** Subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV NGA KOMISIONI

**xi.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### A. VLERËSIMI I PASURISË

#### A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

**xii.** Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Xhemal Saliq.

**xiii.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

**xiv.** Komisioni kreu një hetim të pavarur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore, administruar në dosje, nga ku ka rezultuar si vijon:

**1. Lidhur me apartamentin e banimit me sipërfaqe 71,71 m<sup>2</sup>. Viti i krijimit: 2004. Çmimi i blerjes: 3.500.000 lekë.**

**1.1** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Apartament në blv. “\*\*\*”, kullat “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, Vlorë. Pjesa takuese: 1/2 e pjesës ideale. Mënyra e përfitimit: kontrata e shitblerjes datë 29.4.2004. Burimi i krijimit: kredi nga ProCredit Bank, me vlerë 35.000 euro*”.

**1.2** Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar pasurinë si vijon: “*Shtëpi banimi me sip. 71,71 m<sup>2</sup>. Ndërtuar në vitin 2003. Lagjja “\*\*\*”, rruga “\*\*\*”, Vlorë. Blerë nga firma “\*\*\*\*”. Vlera: 3.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Krijuar në datën 29.4.2004*”.

## **Faktet e rezultuara nga hetimi në lidhje me këtë pasuri**

**1.3** Me kontratën noteriale të shitblerjes datë 29.4.2004, subjekti dhe bashkëshortja e tij, znj.A.S, kanë blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. një apartament me sip. 71,71 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ballkoni 3,22 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, kundrejt çmimit të përcaktuar në kontratë në vlerën 3.500.000 lekë.

**1.4** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar si vijon:

- Në datën 14.5.2004 është lidhur kontrata e huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., midis huadhënësit ProCredit Banka sh.a. dhe huamarrësve, z. Xhemal Saliaj dhe znj. A.S , me objekt “Dhënie huaje në shumën 35.000 euro, me afat shlyerjeje 10 vjet”.

**1.5** Për të siguruar përmbushjen e detyrimit, palët kanë rënë dakord të vendosin hipotekë pasurinë objekt vlerësimi, apartamentin me sip. 71,71 m<sup>2</sup>, dhe pasuri të luajtshme të subjektit, të referuara në aneksin e kontratës, në një vlerë prej 250.000 lekësh.

**1.6** Në vijim, në datën 17.5.2004, është disbursuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit shuma 34.300 euro dhe po në këtë datë kjo shumë ka kaluar në llogarinë e shtetases V.H .

**1.7** Shuma prej 4.384.569 lekësh, e derdhur në llogarinë e shtetases V.H , ka rezultuar e ndryshme nga çmimi i përcaktuar nga palët në kontratën noteriale të shitblerjes datë 29.4.2004, ku palët kanë dakordësuar se çmimi i blerjes është 3.500.000 lekë, duke rezultuar me rreth 884.569 lekë më shumë se çmimi i parashikuar në kontratën noteriale të lidhur mes tyre.

**1.8** Nga administrimi i dokumentacionit të dosjes së kredisë, kontrata e huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., midis huadhënësit ProCredit Banka sh.a. dhe huamarrësve, z. Xhemal Saliaj dhe znj. A.S , ka rezultuar se në raportin e analizës së kredisë përcaktohet:

- *Borxhi prej 4.445.000 lekësh është pjesa mbetur e detyrimit për blerjen e shtëpisë së re tek firma e ndërtimit.*
- *Klienti ka paguar një shumë prej 15.000 euro (1.905.000 lekë), nga të cilat 10.000 euro janë pagesë kësti, ndërsa 5.000 euro janë meremetime që e njëjta firmë ndërtimi do të bëjë tek apartamenti i ri, pasi më përpara ka banuar një familje tjetër, e cila ka bërë rregullime të ndryshme në shtëpi.*

**1.9** Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësitë e subjektit dhe personit të lidhur për të kryer pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit më 29.4.2004, bazuar vetëm në të ardhurat e përfituara deri në datën e blerjes, referuar vlerës së apartamentit prej 50.000 euro, rezultuar nga dokumentacioni i administruar.

**1.10** Kredia bankare nuk u përfshi në këtë analizë financiare si burim krijimi për pagesën e çmimit të blerjes, pasi referuar kontratës së shitblerjes çmimi ishte paguar brenda datës 29.4.2004, ndërsa kredia rezultoi e disbursuar në datën 17.5.2004.

**1.11** Nga analiza financiare e kryer ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për pagimin e apartamentin me sip. 71,7 m<sup>2</sup> në vlerën 50.000 euro, në datën 29.4.2004, duke rezultuar me balancë negative në shumën -6.032.692 lekë.

## Analiza financiare e krijimit të pasurisë

	01.01.2004 - 29.04.2004
<b>A) PASURI</b>	<b>6,350,500</b>
Apartament me sipërfaqe 71,71 m <sup>2</sup> , - L. “***”, Blv “***”, Kullat “***”, Hyrja ***, Vlorë. Pasuria nr. ***, blerë në datë 29.04.2004.	6,350,500
Ndryshim likuiditeti	0
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>6,350,500</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>380,384</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	340,689
Të ardhurat e subjektit nga mësimdhënia në Universitetin *** Vlorë	32,085
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	7,610
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>62,576</b>
Shpenzime jetike	62,576
Balanca e fondeve (D-C-E)	-6,032,692

### 1.12 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën, për sa duket se:

- Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të rremë për çmimin e blerjes së apartamentit, pasi nga dokumentacioni rezultoi se subjekti i ka paguar shtetas V.H më shumë sesa çmimi i vendosur në kontratë dhe, për rrjedhojë, çmimi, si kusht kontraktual, duket se është fiktiv dhe i vendosur në marrëveshje mes palëve sa vlera mesatare e aplikuar në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Vlorës.

- Kredia bankare nuk duket të ketë shërbyer si burim krijimi për pagesën e çmimit të blerjes, pasi referuar kontratës së shitblerjes çmimi është paguar plotësisht brenda datës 29.4.2004, ndërsa kredia rezulton të jetë disbursuar më 17.5.2004.

- Nga analiza financiare për periudhën 1.1.2004 – 29.4.2004, duket se e subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për pagesën e çmimit të apartamentit në datën 29.4.2004.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.13 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet përfundimtare të paraqitura me shkrim, si dhe verbalisht në seancën dëgjimore, pretendoi se vlera e paguar shitëses është vlera e apartamentit siç përcaktohet në kontratë dhe vlera e mobilimit të apartamentit.

1.14 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se çmimi i paguar shitësit është kryer pas disbursimit të kredisë dhe se me shitësin është marrë vesh paraprakisht të shënohej në kontratë për çmimin e paguar plotësisht me qëllim që pasuria të regjistrohej si hipotekë e radhës së parë në pronësi të kredimarrësit, si kusht i panegociueshëm për kreditimin e kredisë.

1.15 Në lidhje me vlerën e pasurisë të vendosur në analizën financiare prej 50.000 euro (kundërvlera e saj 6.350.500 lekë), subjekti e ka kontestuar atë si të pabazuar, duke pretenduar se vlera e vendosur në dokumentacionin e administruar nga banka nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të bankës, pasi dokumenti “Housing summary” është i panëshkruar nga ndonjë punonjës i saj dhe i pavulosur nga ProCredit Bank.

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.16** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet në seancën dëgjimore – arsyeton se:

- Pikat 1, 2 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaratimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarin saktësisht dhe mjaftueshëm të pasurisë dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast është origjina, veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, si dhe mjetet financiare për krijimin e saj.

### **Lidhur me deklarinimin e kësaj pasurie**

**1.17** Trupi gjykues çmon të mos të ndalet në vlerësimin e karakterit ngushtësisht civil të kontratës mes palëve, duke pasur parasysh që procesi i rivlerësimit ka natyrë administrative dhe ka për objekt deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit për kriterin e kontrollit të pasurisë.

**1.18** Komisioni, pasi administroi dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe e dëgjoi atë në seancën dëgjimore, çmon se subjekti ka dhënë shpjegime të pamjaftueshme për të provuar vërtetësinë e deklaratimit të tij lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie apartament banimi.

**1.19** Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit dhe mungesës së ndonjë lidhjeje mes deklaratimeve të subjektit me faktet e rezultuara nga hetimi, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka dështuar të provojë ekzistencën e një lidhjeje të arsyeshme dhe të logjikshme mes shumës së deklaruar në deklaratën *Vetting*, si vlerë e përfitimit të pasurisë prej 3.500.000 lekësh, dhe shumës së paguar në llogarinë e palës shitëse, shtetases V.H , prej 4.384.569 lekësh, si dhe vlerës së deklaruar nga bashkëshortja e subjektit në aplikimin për kredinë bankare, prej 6.000.000 lekësh, pasi këto ishina vlera që nuk përputheshin me njëra-tjetrën.

**1.20** Trupi gjykues, mbështetur edhe në parashikimet ligjore të kohës mbi përfitimin e kreditimit në blerjen e pasurive të paluajtshme, sipas të cilave vlera e kredisë nuk mund të ishte mbi 70% të vlerës së pasurisë së përfituar nëpërmjet kredisë, specifikuar kjo edhe në pikën 6 të formularit të monitorimit financiar të kryer nga banka, arrin në konkluzionin se kontributi i klientit në krijimin e pasurisë, referuar provave dhe dokumentacionit ligjor, është 30%. Klienti ka paguar vlerën prej 15.000 euro (1.905.000 lekë) dhe se huaja bankare e marrë prej subjektit në vlerën 35.000 euro (4.445.000 lekë) është pjesa e mbetur e detyrimit për pagesën lidhur me këtë apartament.

**1.21** Trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, që lidhen me vlefshmërinë e dokumentacionit të administruar nga hetimi administrativ, dosja e analizës së kreditimit në vitin 2004, dhe vlera e vendosur në dokumentin bankar nuk

përfaqëson qëndrimin zyrtar të bankës, pasi dokumenti “Housing summary” është i panënshkruar nga ndonjë punonjës i bankës, dhe aq më pak i vulosur nga ProCredit Bank, nuk mban në konsideratë faktin se në formularin \*\*\*, titulluar “Kërkesë kredie për shtëpi”, dorëzuar bankës nga vetë bashkëshortja e subjektit, ajo ka deklaruar dhe firmosur në datën 8.4.2004 se vlera e investimit të tyre kishte kosto totale 6.000.000 lekë.

**1.22** Edhe shpjegimi i subjektit se vlera e pasurisë është vlera e kredisë, kaluar nëpërmjet bankës përfaqësuese të shoqërisë, nuk mbështetet nga analiza e veprimeve mes palëve.

**1.23** Nga përgjigjet pas rezultateve të hetimit administrativ, subjekti nuk mundi të shpjegojë se si ai dhe bashkëshortja e tij arritën të marrin një kredi nga banka e nivelit të dyte prej 4.384.569 lekësh, duke e garantuar bankën me apartamentin e hipotekuar në vlerën 3.500.000 lekë dhe mobilie në vlerën 250.000 lekë, gjithsej 3.700.000 lekë. Referuar praktikës së kredive bankare, vlera e kolateralit duhet të jetë gjithmonë e njëjtë apo më e madhe se vlera e kolateralit të vendosur, për të siguruar se banka në rast të mospërbushjes së detyrimit të ketë mundësinë reale të përfitimit të të ardhurave të dhëna kredi.

**1.24** Sa më sipër, jo vetëm i gjithë dokumentacioni bankar i administruar lidhur me këtë kreditim, duke përfshirë edhe deklarin e bashkëshortes së subjektit mbi vlerën e investimit, por edhe sa më sipër analizuar lidhur me vlerën e kreditimit dhe kolateralit në një marrëdhënie kreditimi, konfirmojnë se vlera e pasurisë së paluajtshme në deklaratën *Vetting* përmban deklarin të rremë lidhur me çmimin e deklaruar, që nuk provohet dhe as mbështetet nga faktet e hetimit administrativ.

**1.25** Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me vlerën e deklaruar të paguar për përfitimin e kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të analizuara edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

### **Lidhur me mundësinë financiare**

**1.26** Pasi vlerësoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmoi se mbeti e paprovuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të përfituar këtë pasuri në çmimin 50.000 euro.

**1.27** Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt, që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, trupi gjykues vlerësoi se edhe nëse në analizën përfundimtare financiare të kryer do të merrte në konsideratë vlerën e kredisë së përfituar pas pagimit të pasurisë, si burim krijimi për apartamentin në vlerën 4.445.000 lekë, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit në vitin 2004 do të rezultonte me pamundësi financiare për pagimin e vlerës prej 15.000 euro në këtë vit.

**1.28** Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme në vitin 2004, duke mos provuar mundësinë financiare që me të ardhura të ligjshme të mundësonte pagimin e çmimit të kësaj pasurie. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, mbi vlerën e përfitimit të pasurisë, e vendos atë në kushtet e deklarinimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## Lidhur me likuidimin para kohe të kredisë bankare në ProCredit Bank

**1.29** Referuar kontratës së huas së lidhur me ProCredit Bank, është përcaktuar se huaja do të shlyhet për një afat 10-vjeçar. Referuar deklaratave periodike të pasurive në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar se ka shlyer totalisht huan, duke deklaruar se ka marrë hua nga motra e tij, shtetasja J.S (K), shumën prej 17.000 euro, për 3 vite.

**1.30** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se deri në datën 14.7.2009 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur detyrim ndaj bankës shumën 21.631 euro, të cilën e kanë shlyer para kohe në këtë datë, nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 22.000 euro, me përshkrimin “Derdhje për mbyllje kredie”.

**1.31** Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se në këtë shumë përfshihet huaja e marrë nga motra dhe pjesa tjetër kursimet familjare.

**1.32** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, neni 3, pika 14 e tij, subjekti dhe shtetasja J. S (K), si person tjetër i lidhur me subjektin në zbatim të nenit 32/4 të këtij ligji, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të dhëna hua.

**1.33** Subjekti paraqiti dokumentacion provues ligjor në lidhje me të ardhurat e motrës prej punësimit në Greqi, për periudhën 2002 – 2008.

**1.34** Pasi analizoi dokumentacionin në lidhje me të ardhurat bruto të shtetasës J.S. (K), përfituar në shtetin grek nga punësimi për periudhën 2002 – 2008, Komisioni konstatoi se të ardhurat e saj në total nga punësimi janë në shumën 32.665 euro bruto. Komisioni, referuar të dhënave të gjeneruara nga EUROSTAT-i në lidhje me shpenzimet jetike minimale për person në shtetin grek për vitet 2003 – 2008 (pasi për vitin 2002 nuk ka të dhëna), rezultojnë të jenë në shumën 22.927 euro.

**1.35** Nga analizimi i dokumentacionit, duke zbritur vetëm shpenzimet jetike prej 22.927 euro për një person nga shuma bruto e të ardhurave prej 32.665 euro, pa përfshirë këtu shpenzimet e vitit 2002, për të cilat nuk ka të dhëna, dhe pa zbritur detyrimet tatimore nga shuma bruto e të ardhurave të përfituara, shuma që mbetet është 9.738 euro, e pamjaftueshme për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave për shumën e dhënë hua.

**1.36** Si përfundim, për sa rezultoi se shtetasja J.S nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t’i dhënë hua shumën 17.000 euro subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk e ka konsideruar huan e marrë nga motra si burim për shlyerjen e parakohshme të kredisë.

**1.37** Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur me të, për shlyerjen e parakohshme të huas në datën 14.7.2009, në shumën 22.005 euro.

## Analiza financiare për likuidimin para kohe të kredisë bankare

Analiza financiare për shlyerjen para kohe të kredisë	1.1.2009 – 14.7.2009
<b>A) PASURI</b>	<b>296,207</b>
Ndryshim likuiditeti	296,207
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>
Hua e marrë nga shtetasja J.K (S), datë 25.6.2009 (17,000 euro)	-
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>296,207</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>984,385</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	652,021
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	332,364



<b>E) SHPENZIME</b>	<b>3,458,051</b>
Shpenzime jetike	217,843
Shpenzime për shlyerje huaje ndaj ProCredit Bank	3,227,862
Shpenzime udhëtime jashtë vendit	12,345
Balanca e fondeve (D-C-E)	<b>-2,769,873</b>

**1.38 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës,** për sa duket se nga analiza financiare subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare nga të ardhura të ligjshme për të kryer pagesën për shlyerjen e parakohshme të shumës 22.005 euro në datën 14.7.2009, duke rezultuar me balancë negative në shumën -2.769.873 lekë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**1.39** Subjekti, në parashtrimet e tij pas kalimit të barrës së provës ka kërkuar që për efekt analize të konsiderohen përveç të ardhurave të motrës edhe të ardhurat e bashkëshortit të saj për periudhën 2002 – 2008, në shumën 36.111 euro, duke theksuar se nëse këtyre të ardhurave do t'i zbritej shuma e shpenzimeve jetike gjatë kësaj periudhe për bashkëshortin, prej 22.927 euro, shuma e mbetur do të ishte 13.184 euro.

**1.40** Ai ka pretenduar se motra dhe bashkëshorti i saj kanë pasur kursime familjare të mjaftueshme për të dhënë hua shumën 17.000 euro në qershor të vitit 2009 (shuma e disponuar përkatësisht 9.738 euro për motrën dhe 13.184 euro për bashkëshortin e saj).

**1.41** Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave certifikatën e gjendjes familjare të shtetasit J.K dhe dokumentacion nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore të Republikës së Greqisë për shtetasit J. K dhe J.K .

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.42** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës – arsyeton se:

- Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës pas kalimit të rezultateve të hetimit administrativ, rezultoi se motra e subjektit është martuar me shtetasin J.K në datën 26.2.2007 dhe se në përbërjen e gjendjes civile, përveç motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj, rezultoi edhe djali i bashkëshortit të motrës së subjektit, shtetasi Th.K , i datëlindjes 5.11.1988.

**1.43** Të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i motrës së subjektit, në shumën 36.111 euro, u konsideruan referuar të dhënave të depozituara nga vetë subjekti të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve minimale jetike të tij dhe djalit të tij, për vitet 2002 – 2008.

**1.44** Fragmentimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat e krijuara nga motra dhe bashkëshorti, duke nisur nga viti 2002 dhe duke u ndalur te shpenzimet jetike minimale të tyre, pa marrë në konsideratë shpenzimet jetike të djalit të bashkëshortit të huadhënëses, nuk provon se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursime nga të ardhurat e tyre, të provuara, për sa i përket ligjshmërisë për t'ia dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

**1.45** Trupi gjykues arrin në përfundimin se në raport me legjislacionin e zbatueshëm, në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, subjekti nuk ka arritur të provojë

burimin e ligjshëm të krijimit të huas në shumën 17.000 euro, përdorur prej tij për shlyerjen para kohe të huas bankare.

**1.46** Këto të ardhura nga puna, të krijuara nga motra dhe bashkëshorti i saj, duke nisur disa vite para se ata të lidhnin martesën, janë konsideruar nga trupi gjykues të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve minimale jetike të personave të huadhënësve, përkatësisht në vitet 2002 – 2007 për bashkëshortin e ardhshëm të motrës dhe djalin e tij, në vitet 2002 – 2007 për motrën e subjektit, ndërsa pas martesës së tyre, në vitet 2007 – 2008, për motrën, bashkëshortin e saj dhe djalin e tij, duke rezultuar për rrjedhojë të pamjaftueshme për të mundësuar kursimin, për t'ju dhënë në vijim subjektit në formën e huas për shlyerjen e kredisë bankare.

**1.47** Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se të ardhurat e pretenduara nga subjekti, përfituar prej huas së motrës, nuk mund të përfshihen në analizën financiare të shlyerjes para kohe të kredisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, për sa subjekti dështoi të bindte trupin gjykues mbi burimin e ligjshëm të krijimit të huas.

**1.48** Për rrjedhojë, subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare për të kryer pagesën prej 22.005 euro, në datën 14.7.2009, për shlyerjen para kohe të kredisë.

**1.49 Në përfundim, lidhur me apartamentin e banimit me sip. 71,71 m<sup>2</sup> në Vlorë, blerë në vitin 2004, trupi gjykues arrin në përfundimin se:**

- Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* për apartamentin e banimit, duke mos deklaruar vlerën e saktë të përfitimit të pasurisë, e vendos atë në kushtet e deklaratës të pasaktë dhe të pamjaftueshme, në kuptim të parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

- Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagimin e kësaj pasurie të paluajtshme.

- Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagimin para kohe të kredisë bankare.

**1.50** Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të kryer pagesën e çmimit të pasurisë apartament banimi, si dhe pagimin para kohe të kredisë bankare, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**2. Lidhur me apartamentin e banimit me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>. Çmimi i blerjes: 11.000.000 lekë. Viti i krijimit: 2016.**

**2.1** Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting* për këtë apartament, i përfituar me kontratë premtim shitjeje datë 30.3.2016, janë:

- të ardhurat nga shitja e apartamentit nr. \*\*\*, me vlerë 1.400.000 lekë;

- kursimet nga pagat, me vlerë 1.400.000 lekë;
- kredia nga Alpha Bank, dega Vlorë, me vlerë 7.000.000 lekë.

**2.2** Subjekti e ka deklaruar pasurinë në DIPP-në e vitit 2016: *“Apartament me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, në ndërtim nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Çmimi i blerjes: 11.000.000 lekë. Viti i krijimit 2016. Pjesa takuese: ½ e pjesës ideale”*. Në seksionin e detyrimeve, ka deklaruar kredi për blerje banese nga Alpha Bank, në shumën 7.000.000 lekë, me të dhënat e kredisë.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**2.3** ASHK-ja Vlorë informon Komisionin se në pronësi të shtetasve Xhemal Saliaj dhe A.S figuron e regjistruar në datën 21.9.2017 pasuria apartament me sip. 162,12 m<sup>2</sup>, ndodhur në Vlorë.

**2.4** Në datën 30.3.2016 është lidhur kontrata noteriale e premtim shitjes së apartamentit midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në cilësinë e palës shitëse dhe subjektit e bashkëshortes së tij në cilësinë e palës blerëse, për blerjen e apartamentit me sip. 150 m<sup>2</sup> dhe pjesës takuese në ambientet e përbashkëta prej 9 m<sup>2</sup>, të ndodhur në katin e shtatë teknik, kundrejt çmimit total prej 11.000.000 lekësh, i cili do të paguhet me këste sipas kontratës.

**2.5** Në datën 14.9.2017 lidhet kontrata noteriale e shitblerjes midis shitësit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe blerësve, subjektit e bashkëshortes së tij, për blerjen e apartamentit kundrejt çmimit total prej 11.000.000 lekësh.

**2.6** Sipas kësaj kontrate është përcaktuar se nga ky çmim është likuiduar shuma prej 9.800.000 lekësh, ndërsa pjesa që mbetet do të shlyhet brenda datës 14.9.2018.

**2.7** Gjithashtu, në këtë kontratë është përcaktuar se pasuria do t’i kalojë në pronësi palës blerëse pa barrë, pavarësisht mosshlyerjes së plotë të çmimit të shitjes. Rezulton se në vijim pasuria është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në datën 21.9.2017, në pronësi të subjektit e bashkëshortes së tij.

### **Në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes**

**2.8** Referuar kontratës së premtim shitjes datë 30.3.2016, në nenin C të saj është përcaktuar se palët kanë rënë dakord se çmimi prej 11.000.000 lekësh do të paguhet sipas kësteve vijuese:

- Menjëherë me nënshkrimin të kontratës pala blerëse do të derdhë shumën 2.800.000 lekë.
- Shuma 7.000.000 lekë do të paguhet brenda datës 30.6.2016 me lëvrimin e kredisë që do të akordohet nga banka, por jo më vonë se 30.6.2016.
- Në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes do të likuidohet shuma 1.200.000 lekë.

**2.9** Për pagimin e kësteve, subjekti ka deklaruar këto burime:

- Kursimet nga paga të bashkëshortes A.S , me vlerë 1.400.000 lekë.
- Të ardhurat nga shitja e apartamentit nr. \*\*\*, pallati \*\*\*, me vlerë 1.400.000 lekë;
- Kredi nga Alpha Bank, dega Vlorë, me vlerë 7.000.000 lekë.

**2.10** Komisionit nga administrimi dhe analizimi i akteve të publikuara në regjistrin e ASHK-së Vlorë i kanë rezultuar faktet si vijon:

- Në datën 30.3.2016 lidhet kontrata noteriale e premtim shitjes së apartamentit midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në cilësinë e palës shitëse të ardhshme dhe subjektit e bashkëshortes së tij në cilësinë e palës blerëse të ardhshme, për blerjen e apartamentit, tip \*\*\*, 3+1, me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> dhe pjesës takuese në ambientet e përbashkëta prej 9 m<sup>2</sup>, të ndodhur në katin e shtatë teknik, kundrejt çmimit total prej 11.000.000 lekësh, i cili do të paguhet me këste sipas kontratës.

- Në datën 14.9.2017 lidhet kontrata noteriale e shitblerjes midis shitësit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar prej ortakëve G.M e G.M dhe blerësve, subjektit e bashkëshortes së tij, për blerjen e apartamentit kundrejt çmimit total prej 11.000.000 lekësh.

- Sipas kësaj kontrate është përcaktuar se nga ky çmim është likuiduar shuma prej 9.800.000 lekësh, ndërsa pjesa që mbetet do të shlyhet brenda datës 14.9.2018. Gjithashtu, në këtë kontratë është përcaktuar se pasuria do t’i kalojë në pronësi palës blerëse pa barrë, pavarësisht mosshlyerjes së plotë të çmimit të shitjes.

- Rezulton se, në vijim, pasuria është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në datën 21.9.2017, në pronësi të subjektit e bashkëshortes së tij.

### **Në lidhje me burimet e krijimit të të ardhurave**

**2.11** Referuar kontratës së premtim shitjes datë 30.3.2016, në nenin C të saj është përcaktuar se palët kanë rënë dakord se çmimi prej 11.000.000 lekësh do të paguhet sipas kësteve vijuese:

- Menjëherë me nënshkrimin të kontratës pala blerëse do të derdhë shumën 2.800.000 lekë;
- Shumën 7.000.000 lekë do ta paguajë brenda datës 30.6.2016 me lëvrimin e kredisë që do të akordohet nga banka, por jo më vonë se 30.6.2016;
- Në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes do të likuidohet shuma 1.200.000 lekë.

**2.12** Në datën e kontratës, më 30.3.2016, transferohet nga llogaria e shtetasës A.S , në BKT, shuma 1.400.000 lekë me përshkrimin “Tjetërsim pasurie për llogari të shoqërisë “\*\*\*\*”, kontrata me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., blerësi A.S ”. Në këtë llogari janë kredituar pagat e bashkëshortes së subjektit dhe deklaruar kursime në DIPP-në e vitit 2015.

**2.13** Në vijim, në datën 4.4.2016, nga llogaria e shtetasit Xhemal Saliq në Raiffeisen Bank transferohet shuma 1.400.000 lekë me përshkrimin “Pala blerëse sipas kontratës premtim shitjeje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.3.2016”.

**2.14** Në lidhje me këtë pagesë, nisur nga deklarimi i subjektit që si burim krijimi kanë shërbyer edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> vëllait të tij, nga hetimi rezultoi se në datën 20.1.2012, me kontratën noteriale të shitblerjes, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij i shesin ½ pjesë ideale të pandarë të apartamentit nr. \*\*\*, pallati \*\*\*, vëllait të subjektit, shtetasit H.S, kundrejt çmimit 14.500 euro, paguar në datën e lidhjes së kontratës sipas aktit “Depozitim në llogari personale” të Raiffeisen Bank, me përfitues Xhemal Saliq, me përshkrimin “H.S sa derdh për blerje banese”.

**2.15** Subjekti e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 shitjen e këtij apartamenti, si dhe krijimin e një depozite pranë Raiffeisen Bank në shumën 10.000 euro, me të ardhurat nga shitja.

**2.16** Gjithashtu, nga analizimi i deklaratave vijuese të pasurisë, nuk është deklaruar ndonjë ndryshim i gjendjes së depozitës, nga ku subjekti ka paguar këstin e dytë prej 1.400.000 lekësh në datën 4.4.2016, me të ardhurat nga shitja e pjesës takuese të apartamentit vëllait.

**2.17** Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave në shumën 1.400.000 lekë, që kanë shërbyer për pagesën e këstit të dytë, referuar kësaj, ato u analizuan si më poshtë:

- Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, përcakton se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

- Neni 32/1 i ligjit nr. 84/2016 përcakton se subjekti ka detyrimin që bashkë me deklaratën e pasurisë të paraqesë të gjithë dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë.

**2.18** Për sa më lart, Komisioni nuk e ka konsideruar në analizën financiare si të ardhur të ligjshme shumën prej 1.400.000 lekësh për pagesën e këstit të dytë të blerjes së apartamentit, derisa subjekti i rivlerësimit të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion ligjor burimet e krijimit të kësaj shume nga vëllai i tij prej shitblerjes së pjesës takuese në vitin 2012.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**2.19** Subjekti në shpjegimet e tij ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit në lidhje me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të të ardhurave të vëllait, me arsyetimin se vëllai i tij nuk është person i lidhur dhe as person tjetër i lidhur me të.

**2.20** Subjekti i rivlerësimit më tej ka shpjeguar se e ka përmbushur detyrimin për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit të këtyre të ardhurave, pasi shitblerja është kryer me kontratë, të ardhurat kanë kaluar me llogari bankare dhe tatimi është paguar sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke referuar për pagimin e tatimit pagimin e bërë për rivlerësimin e pasurisë të kryer në datën 20.1.2012, në një shumë më të madhe sesa vlera e pasurisë që i është shitur të vëllait.

**2.21** Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se vëllai ka jetuar në atë shtëpi vetëm kur është kthyer në Shqipëri për pushime, duke theksuar se edhe faturimi i energjisë elektrike është vendosur në një masë fikse, duke paraqitur në cilësinë e provës shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2024, të FSHU-së, në lidhje me pagesën fikse prej 340 lekësh, që nga viti 2012.

**2.22** Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përfshirjen në analizë të të ardhurave nga shitja e pjesës takuese të vëllait të tij, duke theksuar se shitja ka qenë reale dhe e provuar me dokumentacion.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**2.23** Trupi gjykues çmon se në analizë të provave të administruara, si dhe shpjegimeve të subjektit në seancë dëgjimore, referuar nenit 32, pika 4 e Ligjit nr. 84/2016, vëllai i subjektit, i cili është në cilësinë e blerësit, nuk gëzon statusin e personit të lidhur e, për pasojë, subjekti nuk ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura prej tij për blerjen e ½ pjesë takuese të apartamentit. Kjo bazohet edhe në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku ndër të tjera citohet: *“...lidhja e interesit që ka ekzistuar mes palëve kontraktuale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme në vitin 2011, nuk përmbush kriteret e parashikuara nga dispozita e sipërcituar, në kuptim të së cilës të mund ta kualifikonte z. Z.K. si person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, ta ngarkonte atë dhe subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave me anë të të cilave është financiar transaksioni i shitblerjes së apartamentit të banimit...”*

**2.24** Por, pavarësisht nga fakti se vëllai i subjektit nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij, Komisioni çmon se nuk ka dyshime për këtë transaksion, pasi kemi një transfertë bankare të kryer në të njëjtën kohë me nënshkrimin e kontratës. Kjo llogari nuk ka pësuar ndryshime në kohë, si dhe kontrata rezulton e deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2012 në vlerën 10.000 euro, shumë e cila është tërhequr në 2016 dhe është një prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

Pra, nuk ka dyshime lidhur me këtë kontratë dhe vërtetësinë e saj. Sa më sipër, kjo vlerë u përfshi në analizën financiare të krijimit të kësaj pasurie.

### **3. Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, ndodhur në Vlorë**

**3.1** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Apartament me çmim blerjeje 1.350.000 lekë. Pjesa takuese: ½ e pjesës ideale. Mënyra e përfitimit: me kontratë shitblerje noteriale datë 1.9.1995. Burimi i krijimit: të ardhurat nga emigracioni ekonomik në Greqi (1991 – 1994)*”.

**3.2** Në deklaratën e parë “Deklarata e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie” datë 17.3.2004, subjekti ka deklaruar: “*Shtëpi banimi 2+1, vlera 1.350.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: nga emigracioni në Greqi dhe kursime familjare*”.

#### **Në lidhje me burimet e krijimit për blerjen e ½ pjesë të apartamentit**

**3.3** Nga analizimi i dy deklaratave të pasurisë, deklaratës *Vetting* dhe deklaratës para fillimit të detyrës të vitit 2003, vërehet se si burim për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e subjektit nga emigracioni në Greqi (në vitet 1991 – 1994).

**3.4** Në këto rrethana, Komisioni gjatë hetimit i ka kërkuar subjektit dokumentacion justifikues për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave nga emigracioni. Subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se nuk ka pasur dokumentacion justifikues për të ardhurat, pasi ka qenë pa dokumente pune, si shumica e shqiptarëve, pavarësisht përpjekjeve për të ndërtuar jetesë mbi baza sa më ligjore të mundshme.

**3.5** Bazuar në deklarinimin e subjektit në deklaratat e pasurisë, sqarimet e dhëna gjatë hetimit, si dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, Komisioni pasqyroj në tabelë financiare blerjen e pjesës takuese të apartamentit në çmimin 675.000 lekë (pjesa takuese e subjektit), ku duket pamundësi financiare e subjektit për të justifikuar me burime të ligjshme çmimin e blerjes për pjesën takuese, në shumën e plotë prej -675.000 lekësh, pa përfshirë në këtë analizë detyrimet e mundshme, shpenzimet jetike, si dhe ato të mundshme të subjektit dhe familjarëve të tij gjatë periudhës deri në blerjen e apartamentit.

**3.6** Mbi bazën e rezultatit financiar, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e pamundësisë financiare për të justifikuar me burime të ligjshme shumën e plotë prej 675.000 lekësh, që përfaqëson pjesën takuese të çmimit të blerjes.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**3.7** Subjekti i rivlerësimit në fillim ka theksuar se pasuria apartament me sip. 70 m<sup>2</sup> është blerë para fillimit të detyrës, 8 vite para se të merrte detyrën si prokuror. Në vijim, për sa i përket burimeve të krijimit dhe detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave, subjekti ka shpjeguar se apartamenti ka si burim të ardhurat e fituara nga emigracioni ekonomik në Greqi

në vitet 1991 – 1994 bashkë me vëllain e tij, ku ka punuar në bujqësi, ndërtim, mobilieri, punë nga të cilat kanë siguruar të ardhura të mjaftueshme për të siguruar jetesën dhe krijuar kursime.

**3.8** Në lidhje me këto të ardhura, ka sqaruar se nuk i ka të dokumentuara, për shkak se, sikundër shumica e shqiptarëve që kanë emigruar në vitet '90, nuk kanë pasur mundësi të sigurojnë dokumentacion të rregullt ligjor, pasi shqetësimi ka qenë mbijetesa.

**3.9** Në lidhje me këtë fakt, subjekti ka pretenduar se ai nuk duhet të penalizohet, pasi të ardhurat janë krijuar 30 vite përpara, para fillimit të detyrës.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**3.10** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet në seancën dëgjimore – arsyeton se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamundësinë financiare për të justifikuar me burime të ligjshme pjesën takuese të pasurisë.

- Në analizë të faktit se kjo pasuri në një vlerësim proporcional dhe objektiv të kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar është krijuar përpara se subjekti i rivlerësimit të ushtronte funksionin publik, për të cilin po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, çmon se për këtë pasuri pamundësia financiare e krijimit të kësaj pasurie, krijuar para marrjes së detyrës nga ana e subjektit, nuk mund ta paralizojë atë, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

- Lidhur me shitjen e kësaj pjese takuese, ajo është arsyetuar më sipër në këtë vendim.

**4. Lidhur me automjetin në përdorim tip “\*\*\*”. Leja e qarkullimit:** lëshuar për shtetasen H.A.S. Data i lëshimit të lejes së qarkullimit: 29.10.2010. Në përdorim me kontrate noteriale.

**4.1** Në lidhje me këtë deklaram, subjekti ka paraqitur bashkë me deklaratën *Vetting* një vërtetim nga Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale, i datës 24.9.2010, sipas të cilit deklarohet se shtetasja H.A.S përfshihet në përfitimet e ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” dhe ka në pronësinë e saj automjetin.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**4.2** DPSHTRR-ja informon se në pronësi të shtetasës H.A.S (nëna e subjektit) rezulton i regjistruar automjeti, referuar certifikatës pronësi e mjetit, lëshuar në datën 10.11.2010.

**4.3** Nga administrimi i dokumentacionit, pjesë e kësaj dosjeje, në datën 8.6.2010 është lidhur aktmarrëveshja midis palës shitëse, shtetasit A.M, dhe palës blerëse, shtetasës H.S, për blerjen e automjetit tip “\*\*\*”, kundrejt çmimit 2.200 euro.

**4.4** Deklarata noteriale e nënshkruar në datën 10.9.2010 përcakton se kujdestari ligjor i nënës, shtetasi H. S (vëllai i subjektit), deklaroi se është dakord që automjetin e të sëmurës ta përdorë, drejtë e qarkullojë shtetasi Xhemal Saliaj, duke pasur çdo të drejtë ligjore që ka të bëjë me drejtimin e mjetit dhe duke marrë përsipër çdo përgjegjësi ligjore që ka të bëjë me përdorimin dhe mbajtjen e tij. Gjithashtu, po sipas kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “Në

*çdo kohë do të jetë i gatshëm t'i shërbejë të sëmurës H.S për transportimin e saj në çdo kohë dhe vend që ajo të ketë nevojë”.*

**4.5** Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se e ka përdorur automjetin për periudhën 2010 – 2016. Gjatë kësaj periudhe ka banuar në Vlorë, ndërsa nëna e tij, referuar akteve të administruara nga hetimi, ka banuar në P , B . Komisioni vëren se largësia midis fshatit B dhe qytetit të Vlorës përfaqëson një distancë të paktën rreth 137 km, apo dy orë me automjet privat, referuar burimeve të hapura të platformës së hartave elektronike *Google Maps*.

**4.6** Në kohën e përfitimit të automjetit, nëna e subjektit ka pasur statusin paraplegjike, invalide e grupit të parë, referuar librezës së identitetit për përfituesit e statusit të invalidit datë 27.4.2010, duke përfituar disa lehtësira për shkak të këtij statusi, sikundër përjashtimin nga taksa doganore mbi automjetin, si dhe nga detyrimet e tjera të cilat sipas deklaratës doganore datë 27.9.2010 përfaqësojnë vlerën 515.620 lekë.

**4.7** Komisioni konsultoi kuadrin ligjor/rregullativ në lidhje me lehtësirat financiare të përfituara nga invalidët paraplegjikë për blerjen/disponimin e automjeteve të përshtatura për ta, ku rezultoi se:

- Ligji nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar, rregullon trajtimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe krijimin e përfitimeve të mundshme me qëllim që ato të marrin pjesë njëjloj si të tjerët në jetën shoqërore.

- Në nenin 16 të tij parashikohet se *personat e sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfshirë këtu edhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.*

- Në nenin 6 të tij parashikohet se *të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta.*

**4.8** Gjithashtu, VKM-ja nr. 387, datë 31.5.2001 “Për përjashtimin nga taksat dhe tatimet të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, i dalë në bazë dhe zbatim të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, në pikën 1 të tij parashikon se:

*“1. Për efekt të zbatimit të nenit 6 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga këto taksa:*

*- Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve;*

*- Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti”.*

**Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e automjetit tip “\*\*\*”**

**4.9** Referuar fakteve të relatuara më sipër, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor që bashkë me deklaratën *Vetting* të shpjegojë bindshëm edhe në lidhje me ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë automjet, të cilën e ka pasur në përdorim për disa vite, bazuar në kuadrin ligjor, ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 11 dhe neni 30.

**4.10** Për sa konstatuar nga hetimi administrativ dhe bazuar në legjislacionin sa më lart, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si vijon:



- i) Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin, që për shkak të tagrit të përdorimit, të shpjegojë bindshëm, si dhe të provojë me dokumentacion ligjor ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e automjetit nga nëna, znj. H. S.
- ii) Subjekti duhet të deklarojë çdo shpenzim të kryer për periudhën që e ka pasur në përdorim, bazuar në tagrat e përcaktuar në aktin e përdorimit datë 10.9.2010.
- iii) Komisioni ngre dyshime të arsyeshme në lidhje me fshehje pasurie nga subjekti i rivlerësimit, duke qenë se gjatë hetimit u provuan këto fakte: (a) përdorimi i automjetit nga subjekti që nga momenti i blerjes së tij; (b) distanca e largët rrugore e cila e bën të vështirë dhe gati të pamundur shërbimin e transportit në çdo kohë të një personi me nevoja të posaçme, siç është e ëma, invalide paraplegjike e grupit të parë.
- iv) Duket se subjekti ka përfituar nga statusi i nënës së tij si invalide, me qëllim krijimin e lehtësirave fiskale për blerjen dhe gëzimin e kësaj pasurie, duke sjellë për rrjedhojë cënimin e etikës dhe integritetit të tij si prokuror.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**4.11** Subjekti shpjegoi se nëna e tij ka pasur mjaftueshëm të ardhura për ta blerë automjetin, për shkak të të ardhurave që ka disponuar, duke cituar këtu: (i) të ardhura të përfituara si invalide paraplegjike për vitin 2010 në shumën 255.770 lekë, provuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2024, të Njësisë Administrative B; (ii) të ardhurat në formën e pensionit të pleqërisë, provuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2024, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, për vitet 1984 – 2016; (iii) të ardhura nga puna bujqësore, si banore e fshatit B; (iv) të ardhurat në formë dhurate nga 7 fëmijët e saj.

**4.12** Këto të ardhura kanë qenë më se të mjaftueshme për të blerë automjetin në vlerën 2.200 euro dhe se nuk ka pasur arsye për ta fshehur blerjen e tij në këtë vlerë, pasi referuar analizës së Komisionit rezultati financiar për vitin 2010 ka qenë pozitiv dhe disa herë më i lartë sesa vlera e automjetit.

**4.13** Në lidhje me shpenzimet e kryera, subjekti ka sqaruar se për sa e ka shoqëruar nënën e tij, në total 5-6 herë në vit, shpenzimet për karburantin kanë qenë të përbalueshme prej tij.

**4.14** Subjekti pretendon se nuk ka përfituar nga statusi i nënës, pasi automjeti është blerë nga vetë kjo e fundit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke theksuar se fryma e ligjit është e tillë që lejon familjarin/të afërmin të drejtojë automjetin për shoqërimin e të sëmurit dhe ka qenë i vetmi fëmijë që mund ta drejtonte për nënën e tij.

**4.15** Subjekti ka pretenduar se nëpërmjet fakteve dhe provave më lart ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pasurinë automjet në përdorim.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**4.16** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratën e përgjigjet e pyetjeve të subjektit në seancën dëgjimore lidhur me këtë pasuri – arsyeton se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ishte bindës në shpjegimet e tij për arsyen e blerjes së këtij automjeti nga nëna e tij dhe arsyet e hartimit dhe nënshkrimit të aktit të përdorimit prej tij të këtij automjeti dhe nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit, për sa më poshtë vijon.

**4.17** Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti nuk depozitoi asnjë dokumentacion të marrë pranë qendrës shëndetësore apo vërtetim lëshuar nga specialistja e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor të zonës ku nëna e tij ishte banore, për të provuar deklaratimet e tij lidhur me kryerjen e kontrolleve shëndetësore të saj.

**4.18** Për më tepër, shpjegimet e subjektit mbi arsyet e hartimit të aktit të përdorimit disa muaj pas blerjes së këtij automjeti mbeten të pabesueshme, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se mbeti e pashpjeguar nga subjekti se përse automjeti nuk u përdor nga kujdestari ligjor i nënës së tij, i cili, sipas deklaratimeve të subjektit, jetonte me të ëmën dhe sipas deklaratimit të tij në seancën dëgjimore ai dispononte edhe leje drejtimi për automjetin.

**4.19** Shpjegimet e subjektit lidhur me situatën faktike të përdorimit të automjetit nuk provuan të kundërtën e fakteve të referuara me rezultatet e hetimit, fakte këto të cilat e bënin të vështirë, gati të pamundur, konsiderimin “bindës” të shpjegimit nga ana e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës.

**4.20** Pretendimet e subjektit se nëna e tij kishte të ardhura si invalide paraplegjike për vitin 2010 dhe të ardhura në formën e pensionit të pleqërisë, vlerësohen nga trupi gjykues si të pamjaftueshme për të provuar mundësinë e nënës, duke vlerësuar se këto të ardhura janë të mjaftueshme vetëm për shpenzimet jetike dhe mjekësore të saj. Për sa i përket dhurimeve, ato mbeten vetëm deklarative dhe të paprovuara nga ana e subjektit.

**4.21** Komisioni çmon se faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit dhe shqyrtimit të kësaj çështjeje, si: (i) marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me automjetin për shkak të përdorimit; (ii) marrëdhënia e nënës së subjektit me këtë automjet - ngeli e paprovuar referuar mundësisë së saj financiare, por edhe përdorimit prej saj të këtij automjeti, fakte që nuk krijuan bindjen se nëna e tij ishte pronarja *de facto* e këtij automjeti.

**4.22** Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti t'i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**4.23** Në vlerësimin e trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga statusi i nënës së tij si invalide, me qëllim krijimin e lehtësirave fiskale për blerjen dhe gëzimin e kësaj pasurie, duke sjellë për rrjedhojë cenim të etikës dhe integritetit të tij si prokuror, pasi kjo mënyrë sjelljeje e zgjedhur prej tij duket se tregon një qasje të caktuar në raport me respektimin e ligjit, zbatimi i të cilit është detyrë themelore e magjistratit edhe jashtë ushtrimit të funksionit të tij.

**4.24** Sjellja e jashtme, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek autoriteti i sistemit të drejtësisë, është objekt rregullimi i normave të etikës së prokurorit dhe pjesë e standardeve që udhëzojnë shembuj më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Në këtë kuptim, kjo çështje u vlerësua të merret në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**5. Tokë arë dhe ullishtë.** Viti i krijimit: 2016. Pjesa takuese: 1/20.

**i. Pasuri arë N. Sipërfaqja 3.500 m<sup>2</sup>.** Numri i pasurisë \*\*\*. Zona Kadastrale \*\*\*. Certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë 14.8.2015. A.S ka pjesë 1/20.

**ii. Pasuri arë N. Sipërfaqja 3.250 m<sup>2</sup>.** Numri i pasurisë \*\*\*. Zona Kadastrale \*\*\*. Certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë 14.8.2015. A.S ka pjesë 1/20.

**iii. Pasuri ullishtë. N. Sipërfaqja 1.750 m<sup>2</sup>.** Numri i pasurisë \*\*\*. Zona Kadastrale \*\*\*. Certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë 14.8.2015. A.S ka pjesë 1/20.

**iv. Pasuri arë N. Sipërfaqja 9.900 m<sup>2</sup>.** Numri i pasurisë \*\*\*. Zona Kadastrale \*\*\*. Certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë 14.8.2015. A.S ka pjesë 1/20.

**6. Pasuri ullishtë N. Sipërfaqja 2.452 m<sup>2</sup>.** A.S ka pjesë 1/20. Adresa N, Vlorë, \*\*\*.

**6.1** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se pasuritë janë përfituar nga bashkëshortja e subjektit me trashëgimi. Referuar akteve të administruara, ka rezultuar se gjyshi i bashkëshortes së subjektit, i ndjeri P. D, ka përfituar si fermer me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi tokë bujqësore me sip. 41.750 m<sup>2</sup>, në N. Në certifikatën e trungut familjar datë 1.8.1991, i ndjeri P.D ka pasur 21 frymë, të cilët kanë përfituar nga ndarja e tokës bujqësore.

**6.2** Në vijim, ka rezultuar se pasuritë janë regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, në datën 13.8.2015, në 1/20 pjesë takuese, në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit, nënës së saj, vëllait dhe motrës, si dhe kushërinjve të tyre, që kanë përfituar me trashëgimi.

**6.3** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**7. Në lidhje me llogari page në lekë, nr. \*\*\*, Alpha Bank, Vlorë, për marrje page.** Hapur në datën 1.3.2016. Gjendja e disponueshme e llogarisë është zero.

**7.1 Llogari rrjedhëse në lekë, nr. \*\*\*, Raiffeisen Bank, Vlorë.** Hapur në datën 2.12.2004. Gjendja e disponueshme e llogarisë është 78,68 lekë.

**7.2 Llogari rrjedhëse në euro, nr. \*\*\*, Raiffeisen Bank, Vlorë.** Hapur në datën 10.2.2009. Gjendja e disponueshme e llogarisë është 4,02 euro.

**Në përfundim,** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këto pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**7.3 Llogari rrjedhëse në lekë, nr. \*\*\*, Banka Kombëtare Tregtare, dega Vlorë.** Gjendja e disponueshme e llogarisë është 610.500 lekë, në emër të A.S .

**7.4 Llogari page në lekë, nr. \*\*\*, Tirana Bank, Vlorë.** Hapur në datën 21.10.2008. Gjendja e disponueshme e llogarisë është zero, në emër të A.S .

**Në përfundim,** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këto pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**7.5 A.S – Depozitë junior me nr. llogarie \*\*\*\*\*, pranë Tirana Bank, për A.Xh.S.** Gjendja e llogarisë është 936,22 euro.

Nga hetimi i Komisionit konstatohet se llogaria është hapur në vitin 2014 si depozitë fëmije dhe deri në vitin 2015 janë depozituar 900 euro në total. Në datën e deklaratës konfirmohet gjendja e deklaruar. Subjekti ka deklaruar këtë depozitë në deklaratat e pasurive, si vijon: (i) në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar: *“Pakësuar pasuria në shumën 638,75 euro. Kjo shumë i ka kaluar djalit tim A.S në nr. llogarie \*\*\*, pranë Tirana Bank”*; (ii) në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar ndryshimin e gjendjes së llogarisë në shumën 928,75 euro.

**Në përfundim**, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë**

**8.** Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 33 të ligjit nr. 84/2016.

**8.1** Në rastin konkret, pamjaftueshmëria financiare, si dhe faktet lidhur me analizimin e pasurisë e çojnë trupin gjykues në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e pasurisë sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe në vlerësimin tërësor ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

**8.2** Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrin kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, rrethanat dhe konkluzionet e arritura më lart çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**9.** Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**9.1** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

**9.2** Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

**9.3** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Xhemal Saliaj.

**9.4** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, z. Xhemal Saliaj. Nga hetimi i Komisionit nuk u gjetën indicie apo elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzion i Komisionit për kontrollin e figurës**

**10.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

**10.1** Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliaj, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**11.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional të subjekteve, ka depozituar pranë Komisionit raportin profesional bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi”, duke iu referuar kritereve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

**11.1** Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e akteve vijuese: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iv) 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (v) të dhënave nga 23 prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

**11.2** Nga analizimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjeve me short në kuptim të kritereve të rivlerësimit, evidentohen këto gjetje:

#### **Aftësitë profesionale**

##### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatimin e ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. \*\*\*, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore” (dosja 4 dhe dosja 5). Rezulton se

qëndrimet e prokurorit janë mbështetur nga drejtuesi i Prokurorisë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Nga pikëpamja gjuhësore ka respektuar rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur. Aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit janë të konceptuara përgjithësisht në tri pjesë. Rezulton se në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit i kushtohet rëndësi pasqyrimit të përmbajtjes së provave, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme përmbajtjen e tyre, si dhe tregimin e rrethanave të faktit. Në përmbajtjen e akteve formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e shortuara janë analizuar në mënyrë të hollësishme elementet e veprës penale objekt hetimi. Në konkluzionet përfundimtare janë respektuar kërkesat për llojin dhe masën e dënimit, të parashikuara nga neni 47 i Kodit Penal, që ka të bëjë me mënyrën e caktimit të tij. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

#### **Aftësitë organizative**

##### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti Xhemal Saliaj në periudhën e rivlerësimit ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga të dhënat statistikore për periudhën e rivlerësimit, prokurori Xhemal Saliaj ka trajtuar gjithsej 338 çështje (procedime dhe kallëzime) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku nuk përfshihen çështjet e pezulluara.

Subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliaj, ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore.

Subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliaj, ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materialesh hetimore. Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve të tij ligjore, konstatohet se prokurori ka përballuar ngarkesë pune normale gjatë periudhës së rivlerësimit.

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve procedurale, ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mospërgatitjen e tij për çështjen në gjykim.

Nga hetimi i dosjeve të zgjedhura nga subjekti dhe atyre të përzgjedhura me short, në raport konstatohet se vetëm vendimi i mosfillimit i procedimit penal për dosjen nr. 1 është marrë tej afatit 30-ditor të parashikuar në udhëzimin nr. \*\*\*, datë 19.6.2012 “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. \*\*\*, datë 21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm, dhe kjo për shkak se pritej administrimi i aktit të ekspertimit teknik. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal dhe Kushtetutës, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliaj, është eficient dhe efektiv.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Xhemal Saliaj, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e Gjykatës. Gjithashtu, vërehet se hetimet në dosjet e shortuara janë kryer brenda afateve ligjore.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar se gjuha e përdorur në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

#### *b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej subjektit, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit e i qartë.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

#### *c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Xhemal Saliaj, rezulton t'i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, ku ka deklaruar angazhimet në trajnimet/seminaret e organizuara nga kjo Shkollë, si dhe në organizata ndërkombëtare.

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE**

**12.** Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit, z. Xhemal Saliaj, rezulton se:

Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 10.10.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit, z. Xhemal Saliaj, ka marrë masën disiplinore “Kalim në një detyrë më të ulët brenda sistemit të prokurorisë”, për një periudhë 18 muaj, duke nisur nga data 15.10.2012 deri më 15.4.2014, për të kryer detyrën e oficerit të policisë gjyqësore. Nga dokumentacioni i administruar vërehet se masa disiplinore i është dhënë subjektit gjatë ushtrimit të detyrës si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Berat për shkelje administrative gjatë ushtrimit të detyrës.

**12.1** Në vijim urdhri është ankimuar në Gjykatën e Apelit, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.1.2013, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesëpadisë pjesërisht;*
- *Anulimin e urdhrin nr. \*\*\*, datë 10.10.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë “Për dhënie mase disiplinore” ndaj paditësit Xhemal Saliaj;*
- *Fshirjen nga dosja personale e paditësit Xhemal Saliaj të masës disiplinore të dhënë ndaj tij me urdhrin nr. \*\*\*, datë 10.10.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.*
- *Rikthimin e paditësit Xhemal Saliaj në vendin e mëparshëm të punës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.*
- *Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit Xhemal Saliaj pagën e plotë si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nga data 10.10.2012 deri në rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.*
- *Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër.*

**12.2** Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.10.2017.

**12.3** Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2020, rezulton se ka pasur 2 ankesa, për të cilat, pasi janë administruar, nuk janë evidentuar shkelje për subjektin e rivlerësimit.

**12.4** Nga të dhënat e administruara në lidhje me vlerësimin e punës së subjektit, vërehet se është vlerësuar për performancën e viteve 2014 – 2016, si vijon:

- Me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2014, për prokurorin Xhemal Saliaj në nivelin “shumë mirë”;
- Me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2015, për prokurorin Xhemal Saliaj në nivelin “shumë mirë”;
- Me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2016, për prokurorin Xhemal Saliaj në nivelin “shumë mirë”;



## **Rivlerësimi profesional i kryer nga Komisioni**

**13.** Komisioni analizoi në mënyrë të pavarur dokumentet që kanë shërbyer për kryerjen e vlerësimit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit. Nga analizimi i tyre u evidentuan disa gjetje në dosjet e shortuara, si vijon:

### **14. Dosja nr. 3, që i përket procedimit penal nr. \*\*\*/2015**

#### **Rrethanat e faktit**

**14.1** Mbi bazën e referimit nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Vlorë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 30.6.2015, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290, paragrafi i dytë i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit N .Ll . Nga analizimi i aktit “Informacion për referim të veprës penale”, datë 30.6.2015, rezulton se në datën 29.6.2015, rreth orës 22<sup>50</sup>, është arrestuar në flagrancë shtetasi N. Ll , sepse duke drejtuar automjetin e tij tip “\*\*\*\*”, me targë AA \*\*\*, ka aksidentuar shtetasin B.Rr . Ky i fundit nga ana e tij ishte duke drejtuar motoçikletën tip “\*\*\*\*”, me targë \*\*\*. Si rezultat i përplasjes së dy mjeteve ka pësuar dëmtime shtetasi B. Rr , i cili është dërguar në Spitalin Rajonal të Vlorës për të marrë ndihmën e duhur mjekësore.

**14.2** Pasi janë kryer veprimet e para hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore, në funksion të arrestit në flagrancë, subjekti i rivlerësimit ka proceduar brenda afatit ligjor me vleftësimin e ligjshëm të kontrollit personal, duke i kërkuar Gjykatës vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë për shtetasin N.Ll , si dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

**14.3** Në vijim, subjekti ka proceduar me vleftësimin e veprimeve të tjera hetimore të kryera nga OPGJ-ja. Për ekzaminimin e dëmtimeve të të dëmtuarit është caktuar eksperti, i cili me aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. \*\*\*, datë 1.7.2014, ka konkluduar se tek i dëmtuari konstatohen plagë në kokë dhe thyerje e kockës së shpatullës, të cilat klasifikohen në kategorinë e dëmtimeve që sjellin paaftësinë e përkohshme në punë mbi 9 ditë.

**14.4** Mbi bazën e këtij akti dhe pas përfundimit të veprimeve hetimore, subjekti në datën 3.9.2015 ka proceduar me vendimin për pushimin e çështjes penale, pasi vepra penale nuk ekziston, me arsyetimin se kategoria e dëmtimeve është e tillë që ka sjellë paaftësi të përkohshme të punës dhe jo pasoja penale (plagosje e lehtë/e rëndë apo vdekje).

**14.5** Në fashikullin hetimor është administruar akti “Formular i verifikimit të përdorimit të pijes alkoolike”, lëshuar nga Komisarati i Policisë Vlorë, ku citohet se “*Drejtuesit të mjetit iu bë testi i alkoolit me gyp qelqi nga ana e frymëmarrjes dhe rezulton se drejtuesi ka përdorur alkool deri në 0,3%*”, për të cilin vetë drejtuesi i mjetit ka deklaruar se është dakord.

**14.6** Mbi bazën e gjetjeve, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime shteruese në lidhje me vlerësimin nga ana e tij të rezultatit të testit të alkoolit në kuptim të kryerjes së veprimeve të mëtejshme hetimore për zbardhjen e fakteve penale, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin konkret në kuptim të veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**14.7** Subjekti nëpërmjet parashtrimeve të tij i sqaroi Komisionit se në rastin konkret nuk ekziston vepra penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, pasi sipas Kodit Rrugor, neni 184, pika 2, shkronja “d”, duhet që masa e alkoolit e konstatuar në momentin e testit të jetë në vlerën mbi 0,5 gramë/litër.

## **Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm**

**14.8** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet hetimore ezauruese për të provuar shkeljet e konstatuara, të cilat kanë dëmtuar shëndetin e shtetasit B.Rr .

## **15. Dosja nr. 4, lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2016**

### **Rrethanat e faktit**

**15.1** Shtetasja S.S , me detyrë inspektore e policisë së rendit, gjatë kryerjes së detyrës së saj, për të dokumentuar veprimet lidhur me një konflikt të ndodhur në një banesë në Vlorë, është shtyrë e goditur nga shtetasi M.V. Për këtë arsye, në datën 16.5.2016 ajo ka depozituar kallëzim penal, për të cilin me urdhrin datë 18.5.2016 të subjektit të rivlerësimit është vendosur regjistrimi i veprës penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal, me person nën hetim shtetasin M.V .

**15.2** Nga faktet konstatohet se në datën 16.5.2016 janë njoftuar shërbimet e policisë gjyqësore se në lagjen “\*\*\*\*” të qytetit të Vlorës, në një banesë private, ka ndodhur një konflikt midis dy familjeve. Menjëherë, këto shërbime kanë shkuar në vendin e ngjarjes për të vërtetuar saktësinë e informacionit dhe nga kryerja e veprimeve të para hetimore kanë dokumentuar se konflikti kishte ndodhur për shkak të prishjes së një muri ndarës të banesës. Në grupin e punës ka qenë kallëzuesja, si dhe dy oficerë të tjerë të policisë Vlorë. Teksa po bisedonin për ngjarjen e mësipërme dhe po sqaroheshin për motivet e konfliktit, ka ardhur shtetasi M.V , i cili ka dashur të hyjë në banesën e xhaxhait të tij N.V , personi që njoftoi policinë për konfliktin. Znj. S i ka bërë të ditur se nuk duhej të futej brenda në banesë, pasi kishte ende veprime për t’u bërë në vendngjarje, kështu që duhej të largohej, por shtetasi M.V nuk është larguar dhe është përgjigjur duke i thënë se “...nuk keni punë në banesën e xhaxhait tim...”, madje ka filluar të ofendojë me fjalë të ndryshme. Ajo i ka dalë përpara për ta penguar të hynte brenda në banesë, por në këtë moment shtetasi M.V e ka shtyrë, si dhe e ka goditur znj. S me një shkelm poshtë gjurit të këmbës së majtë. Më pas, shtetasi M.V ka tentuar të largohet me vrap në drejtim të banesës së tij, por në këtë kohë kanë ndërhyrë edhe kolegët e znj. S, të cilët e kanë kapur dhe e kanë futur në automjetin e policisë.

**15.3** Subjekti i rivlerësimit, pasi ka marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarëve dy oficerët e tjerë të pranishëm në vendngjarje, të cilët kanë konfirmuar faktet e ndodhura, si dhe të pandehurin, ka proceduar në datën 20.5.2016 (pra, dy ditë pasi ka regjistruar veprën penale në ngarkim të tij) me kërkesën për gjykim në ngarkim të të pandehurit për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.

**15.4** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit M.V për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” dhe dënimin e tij me 50.000 lekë gjobë.

**15.5** Në procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi për të cilin zhvillohen hetimet, datë 20.5.2016, vërehet se i pandehuri M.V ka deklaruar se ai ka ndërhyrë ndaj forcave të policisë, pasi ka parë që ato kanë kapur vëllain e tij të mitur nga shpatullat duke e shtyrë, me ton të lartë dhe duke përdorur fjalor të papërshtatshëm. Në lidhje me këtë deklaram nuk konstatohet asnjë veprim i mëtejshëm hetimor i ndërmarrë nga subjekti për të sqaruar këtë deklaram në raport me faktet penale të paraqitura në këtë procedim. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për sa kishte konstatuar.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**15.6** Subjekti ka shpjeguar se nga tërësia e akteve procedurale që përmban fashikulli hetimor, nuk ka dalë asnjë e dhënë tjetër lidhur me pretendimin e ngritur nga shtetasi M.V , duke shtuar se deklaruesit e ndryshëm që janë pyetur lidhur me rrethanat e faktit nuk e kanë evidentuar në asnjë moment vëllain e mitur të M aty rreth konfliktit. Subjekti ka theksuar në lidhje me këtë çështje se shtetasi M.V nuk ka qenë i besueshëm për faktet dhe rrethanat e referuara, duke sqaruar deklaramet kontradiktore të tij kur është pyetur në lidhje me akuzën e goditjes së punonjësit të policisë.

#### **Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm**

**15.7** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet hetimore ezauruese për të provuar shkeljet e pretenduara nga ana e shtetasit M.V , si dhe nuk ka arsyetuar në vendimin e marrë pretendimin e ngritur prej tij.

### **16. Dosja nr. 5, lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2016**

#### **Rrethanat e faktit**

**16.1** Nga aktet e administruara rezultoi se në datën 15.4.2016 shtetasi A.N , student në universitetin “\*\*\*” të qytetit të Vlorës, ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit E.K, student në këtë universitet, duke e akuzuar se i ka vjedhur në dhomën e konviktit një bluzë dhe biçikletën e tij personale, ngjarje e dyshuar të ketë ndodhur në datën 23.2.2016. Në datën 15.4.2016, rreth orës 02:45, policia ka arrestuar në flagrancë të dyshuarin E.K si autorin e kryerjes së veprës penale.

**16.2** Subjekti i rivlerësimit, në çmim të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Me këtë akt shtetasi E.K është marrë i pandehur për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

**16.3** Në vijim, subjekti ka paraqitur kërkesën për gjykim duke kërkuar deklaramin fajtor të të pandehurit E.K për kryerjen e veprës penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134, paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 150.000 lekë gjobë.

**16.4** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.4.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur:

- 1. Deklaramin fajtor të të pandehurit E.K për kryerjen e veprës penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134, paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 150.000 lekë gjobë.*
- 2. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit E.K me 100.000 lekë gjobë.*

**16.5** Komisioni, pasi analizoi faktet dhe provat e administruara në dosje, nga vlerësimi i fakteve vlerësoi se nuk ka pasur gjendje flagrante, që të procedohej me arrestin në flagrancë të shtetasit E.K , pasi faktet penale nuk kishin ndodhur në moment, por muaj më parë.

Gjithashtu, duket se arrestimi në flagrancë i kryer ndaj shtetasit E.K në orën 02:45 nuk ka justifikuar urgjencën e veprimit dhe, për rrjedhojë, duket se i është mohuar e drejta bazë e mbrojtjes me një avokat, pasi në atë orë i pandehuri nuk kishte kohën efektive të zgjidhte avokatin mbrojtës. Mbi bazën e këtyre gjetjeve, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**16.6** Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij ka sqaruar se referuar nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale gjendje e flagrancës konsiderohet edhe rrethana kur personi kapet me sende e prova, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale. Në rastin konkret, shtetasi E.K është kapur me bluzën e veshur, të cilën ia kishte vjedhur shtetasit A.N . Për më tepër, edhe gjykata e ka konsideruar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të tij.

**16.7** Gjithashtu, subjekti ka theksuar se ky shtetas nuk ka pasur pretendime në lidhje me mbrojtjen në asnjë moment, madje edhe kur është pyetur si i pandehur, në datën 15.5.2016, nuk ka pranuar ndihmën e mbrojtësit.

### **Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm**

**16.8** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar masën e sigurimit në kushtet e flagrancës në përputhje me nenin 252 të Kodit të Procedurës Penale, i cili është vlerësuar edhe nga gjykata si i ligjshëm. Komisioni çmon se nga ana e subjektit nuk janë respektuar elementet e një procesi të rregullt ligjor, duke i mohuar personit në hetim të drejtën për të marrë avokat, e drejtë kjo e cila rezulton të mos i jetë shpjeguar personit të arrestuar në kushtet e flagrancës.

### **Ankesat e paraqitura ndaj subjektit referuar burimeve arkivore**

**17.** Komisioni verifikoi dhe analizoi edhe ankesat e paraqitura ndër vite ndaj subjektit të rivlerësimit, referuar burimeve arkivore, ku u evidentua si vijon:

#### **18. Lidhur me ankesën e paraqitur nga shtetasi Dh.K**

**18.1** Nga administrimi i fakteve të paraqitura vërehet se ankuesi është kallëzuar nga bashkëshortja për dhunë të ushtruar ndaj saj, ku mbi bazën e kallëzimit, në datën 4.2.2014, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e tij si person nën hetim për veprën penale “Dhuna në familje”.

**18.2** Ankuesi pretendon se nga kjo datë e deri në kohën kur i ka dërguar ankesën Prokurorit të Përgjithshëm, kanë kaluar 3 muaj dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim parashikuar në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit duhej ta dërgonte çështjen në gjyq, ta pushonte apo pezullonte. Për më tepër, ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes i ka bërë presion për nënshkrimin e njoftimit të vendimit për zgjatjen e afateve, vendim të cilin, sipas denoncuesit, subjekti e ka nxjerrë pasi ka marrë dijeni për ankesën e tij drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Mbi bazën e këtyre fakteve, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me pretendimet e denoncuesit, si dhe të paraqesë dokumentacion provues në lidhje me ndjekjen e procedurave për përfundimin e hetimeve paraprake për këtë çështje.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**18.3** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ankuesi ka depozituar një kërkesë në Prokurori me objekt “Pushimi i çështjes penale për shkak të kalimit të afateve”. Në lidhje me këtë çështje, subjekti ka sqaruar veprimet e ndjekura, si vijon: *Shtetasi Dh. K është ndaluar në datën 24.3.2014, pavarësisht se emri i tij si autor ishte regjistruar më parë. Vetëm në datën e ndalimit janë kryer disa veprime hetimore, si këqyrja dhe marrja e disa dokumenteve, marrja e të dhënave nga persona që kanë dijeni për rrethanat e hetimit. Më tej, subjekti ka shtuar se veprimtaria hetimore është zhvilluar sipas dinamikës së diktuar të hetimit dhe palët kanë firmosur aktet. Në përfundim, çështja është dërguar për gjykim.*

**18.4** Në lidhje me pretendimin për presion për nënshkrim njoftimi në zgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti e ka mohuar atë, duke sqaruar gjithë procedurën e njoftimit për vendimin e zgjatjes së afatit dhe kundërshtimin e tij për ta firmosur atë në ambientet e paraburgimit në prani të oficerit të policisë gjyqësore në mënyrë periodike, duke cituar datat 14.5.2014, 16.5.2014 dhe 19.5.2014. Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues në lidhje me këtë çështje.

## **Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm**

**18.5** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se nuk ekzistojnë elemente të vlerësueshme lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

## **19. Lidhur me gjetjet e konstatuara gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës si drejtues të subjektit të rivlerësimit**

**19.1** Në lidhje me ankesën nr. \*\*\*, viti 2010, të paraqitur nga shtetasi A.V . Ky shtetas ka paraqitur ankesë, ndër të tjera edhe ndaj subjektit të rivlerësimit si drejtues Prokurorie. Ankuesi ka parashtruar se padrejtësisht është marrë i pandehur dhe se me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.1.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështja penale dhe akuza ndaj tij është pushuar.

**19.2** Nga analizimi i dosjes në lidhje me këtë ankesë, vërehet se çështja është shqyrtuar nga një prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Berat, ku subjekti ka qenë drejtues. Rezulton se ankuesi është dërguar në gjyq për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, pasi gjatë ushtrimit të detyrës si shëf i krimeve në Komisariatit e Policisë Skrapar nuk ka ndjekur për ekzekutim dënimi vendimin e Gjykatës së Lartë ndaj dy të pandehurve, akuzuar për veprën penale “Vrasja me dashje” në bashkëpunim dhe, nga mosndjekja e vendimit, të burgosurit kanë përfituar më vonë nga amnistia, ku më pas janë liruar.

**19.3** Në vijim, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Berat, nr. \*\*\*, datë 3.12.2008, është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes penale nr. \*\*\* regj./2008, në ngarkim të të pandehurit A.V , akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, për shkak se procedimi nuk duhej të fillonte, pasi mungojnë elementet e kësaj figure krimi. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.1.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

**19.4** Komisioni, bazuar në urdhrin nr. \*\*\*, datë 9.5.2008 “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë të Prokurorit të Përgjithshëm”, pika 3<sup>1</sup> e tij, në lidhje me kontrollin nga prokurori më i lartë të bazueshmërisë ligjore të prokurorit më të ulët, i

---

<sup>1</sup> Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, para se të nënshkruajnë shkresat për kalimin e akteve të prokurorit në gjykatë... kanë për detyrë të kontrollojnë bazueshmërinë në ligj të akteve dhe procedimit penal. Ata marrin përgjegjësi për kontrollin e zgjidhjes ligjore dhe/ose formulimin e aktit nga prokurori më i ulët.

ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime në lidhje me kontrollin e ushtruar nga ai si drejtues prokurorie, si dhe qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**19.5** Subjekti i rivlerësimit, pasi ka sqaruar dinamikën e kësaj çështjeje, ka shpjeguar se ka ushtruar me kompetencë të plotë detyrën në lidhje me kontrollin e kryer si prokuror më i lartë në lidhje me këtë çështje, nëpërmjet siglimit të vendimit të prokurorit të çështjes “Për dërgimin e çështjes në gjyq”, datë 11.9.2008, ka paraqitur në cilësinë e provës vendimin e cituar.

### **Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm**

**19.6** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar në mënyrë të plotë dhe ezauruese kompetencat e tij, bazuar në urdhrin nr. 147, datë 9.5.2008 “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, të Prokurorit të Përgjithshëm, pika 3, të cilat nuk kanë pasur të bëjnë në atë kohë vetëm me siglimin e kërkesës për gjyq.

## **20. Në lidhje me disa gjetje të raportit të auditimit të Prokurorisë së Përgjithshme, i kryer në vitin 2002**

**20.1** Gjatë administrimit të informacioneve të marra nga burimet arkivore, ka rezultuar se nga një auditim i kryer nga Prokuroria e Përgjithshme për veprimtarinë financiare në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, në bazë të urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, datë 28.6.2012, për vitet 2011 – 2012 është konkluduar se nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat ka pasur shkelje lidhur me shpenzimet e transportit, pasi ka përfituar shërbime udhëtimi me automjetin e punës, ndërkohë që ai ka përfituar “bonus” në bazë të ligjit nr. 10160/2009, duke i shkaktuar institucionit një dëm prej 930.457 lekësh. Duke u bazuar në raportin e auditimit, Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat të hartojë plan veprimi për zbatim, ku të përfshihej arkëtimi i shumës prej 930.457 lekësh.

**20.2** Në vijim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka nxjerrë urdhrin nr. \*\*\*, datë 29.10.2012, sipas të cilit urdhërohet që të mbajë nga paga e subjektit shumën 15.000 lekë/muaj deri në shlyerjen e plotë të vlerës së dëmit.

**20.3** Duke mos qenë dakord, subjekti e ka ndjekur çështjen në rrugë gjyqësore, duke i kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat anulimin e ndalesave nga paga e tij për shkak të pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, si dhe kthimin e të gjitha shumave të mbajtura si pasojë e zbatimit të urdhrin nr. \*\*\*, datë 29.10.2012.

**20.4** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, është vendosur pranimi pjesërisht i padisë, duke anuluar ndalesat nga paga e paditësit, si dhe detyrimin e të paditurve t’i kthejnë paditësit të gjitha ndalesat e mbajtura. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.5.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

**20.5** Nga analizimi i vendimit i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat vërehet se gjykata nuk ka shqyrtuar në materie nëse raporti i auditimit është i drejtë dhe nëse dëmi i shkaktuar ekziston apo jo. Kjo gjykatë ka vlerësuar natyrën e akteve të lëshuara në lidhje me këtë çështje, duke i konsideruar si administrative e që nuk mund të lëshohen për shpërblimin e dëmeve në fushën e marrëdhënieve të punës, por duhet të kërkojnë në rrugë gjyqësore. Nga administrimi i informacionit, vërehet se grupi i audituesve ka gjetur disa shkelje për sa i përket mënyrës se si subjekti ka lëshuar autorizimet për përdorimin e dy automjeteve që kanë qenë në dispozicion të

Prokurorisë së Rrethit Berat për periudhën 2011 – 2012, si dhe veçanërisht shkelje në lidhje me përdorimin nga subjekti i rivlerësimit të një prej automjeteve të Prokurorisë, në rrethanat kur ka përfituar gjithashtu shpenzime transporti. Përveç kësaj, shkelja ka konsistuar gjithashtu edhe në lëshimin e autorizimit për përdorimin e automjeteve nga subjekti i rivlerësimit.

**20.6** Bazuar në këto fakte, Komisioni i kërkoi subjektit qëndrimin e tij në lidhje me pretendimet e ngritura nga audituesit e Prokurorisë së Përgjithshme për shkeljet e kryera për shkak të përdorimit të automjeteve të punës; nëse është ndjekur procedura për lëshimin e autorizimeve për përdorimin e tyre, si dhe dëmin e shkaktuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat gjatë ushtrimit të detyrës si drejtues Prokurorie të subjektit të rivlerësimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**20.7** Subjekti në shpjegimet e paraqitura ka theksuar se si drejtues i Prokurorisë të Rrethit Berat ka kryer me korrektësi dhe ligjshmëri funksionin e ngarkuar dhe se nuk ka kryer shkelje të ligjit, duke e bazuar këtë në vendimet e gjykatës, të cilat kanë vendosur me vendim të formës së prerë rrëzimin e kërkesëpadisë të ngritur nga Prokuroria e Përgjithshme, duke e detyruar të kthejë në favor të subjektit shumën monetare në vlerën 930.457 lekë. Subjekti ka shtuar se në përmbajtje të këtyre vendimeve arsyetohet se përdorimi i automjeteve ka qenë në përputhje me ligjin dhe funksionin e drejtuesit të Prokurorisë. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës praktikën gjyqësore në lidhje me këtë çështje.

### **Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm**

**20.8** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit nuk kanë qenë objekt i rishikimit gjyqësor dhe, për pasojë, janë konstatuar si të tilla gjatë ushtrimit të detyrës së subjektit si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Këto shkelje do të vlerësohen në raport me gjetjet e tjera gjatë procesit të rivlerësimit, duke u marrë në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

## **DENONCIME**

Nga verifikimi i regjistrimit të denoncimeve të Komisionit, u evidentuan 2 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, të cilat paraqiten si vijon:

**21. Denoncim i shtetasit A.T,** i cili ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi, duke paraqitur pretendimet përkatëse. Për subjektin e rivlerësimit pretendon se nuk ka kryer hetim, duke e shpallur fajtor. Nga administrimi i dokumentacionit ligjor të paraqitur nga denoncuesi vërehet se denoncuesi ka bërë kallëzim pranë Prokurorisë së Rrethit Berat në datën 3.3.2010. Hetimi i këtij kallëzimi është kryer nga prokurori A. Ç., i cili, pasi ka kryer veprimet hetimore, me vendimin e datës 23.3.2010 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi nuk rezulton që të ketë vepër penale. Vërehet se subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, i cili ka komunikuar vendimin e mosfillimit dhe nuk rezulton të ketë qenë prokuror i çështjes, siç pretendohet në denoncim.

**22. Denoncim i shtetasit K.C,** i cili ka kallëzuar subjektin e rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Vlorë dhe gjyqtarin e çështjes për shpërdorim detyre, kryerjen e veprimeve arbitrare ndaj tij.

**22.1** Nga administrimi i denoncimit vërehet se denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, në çështjen që ka hetuar ndaj tij, ka ndërmarrë veprime arbitrare, si kundërvënje të kallëzimeve

publike të bëra në media ndaj drejtuesve të universitetit “\*\*\*\*” Vlorë për korrupsion pasiv gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, ku përfshihet edhe bashkëshortja e subjektit si pedagoge/dekane pranë këtij universiteti. Sipas denoncuesit, referohen këto shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit:

- Procedimi penal është regjistruar në vitin 2015 nga subjekti i rivlerësimit për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe, duke qenë se në këtë periudhë prokurori kaloi tek seksioni i ekzekutimeve penale, e dorëzoi këtë çështje, dhe pas 5 vitesh e rimerr përsëri. Denoncuesi ngre pretendime në lidhje me shortin, ku sipas denoncuesit nuk ka marrë asnjëherë përgjigje në lidhje me këtë çështje nga drejtuesi i Prokurorisë, duke ngritur dyshime për bashkëpunim në arbitraritet edhe ndaj drejtuesit të Prokurorisë, pasi edhe gruaja e tij është pedagoge pranë këtij universiteti.

- Parashkrim i veprës penale për të cilën është akuzuar, pasi procedimi penal është regjistruar në datën 25.1.2015 dhe falsifikimi i pretenduar ka ndodhur në vitin 2009. Komisioni, duke vlerësuar si indicie pretendimet e denoncuesit, kërkoi dhe administroi dosjen e plotë penale, ku pas vlerësimit të veprimeve hetimore të ndjekura nga prokurori në raport me faktet e kallëzuara rezultoi si vijon: Bazuar në kallëzimin e shtetasit A.Sh , datë 15.1.2015, si dhe të kallëzimit të Ministrisë së Arsimit, datë 14.4.2015, mbi bazën e denoncimit në portalin “\*\*\*\*” është kallëzuar se shtetasi K.C nuk e ka përfunduar shkollën e mesme (viti i mbarimit 1989), pasi nuk ka qenë i regjistruar. Gjithashtu, edhe kur ka filluar studimet e larta, vitin e parë akademik nuk e ka kryer (2008 – 2009), pasi në mars 2009 ka qenë i burgosur në shtetin italian për lëndë narkotike. Pasi ka përfunduar studimet për Drejtësi, ka përfituar edhe titullin avokat mbi bazën e një diplome, e cila ka përmbajtje të rreme.

**22.2** Nga materialet e dosjes vërehet se me urdhrin datë 20.3.2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A.Sh ndaj shtetasit K.C dhe bashkëshortes së tij, pasi në bashkëpunim kallëzohen se kanë falsifikuar dokumente (diploma), të cilat i kanë përdorur për kandidim në zgjedhjet parlamentare etj.

**22.3** Gjithashtu, mbi bazën e kallëzimit penal të Ministrisë së Arsimit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2015. Sipas këtij kallëzimi, është referuar nëpërmjet portalit “ \*\*\*\*” se shtetasi K.C ka falsifikuar dokumentet duke u regjistruar në Universitetin \*\*\* për vitin 2008 – 2009, ndërkohë që në këtë kohë ka qenë në burg në Itali, pasi ishte i dënuar për trafikim të lëndëve narkotike. Me vendimin për bashkimin e procedimeve të drejtuesit të Prokurorisë Vlorë, datë 21.9.2016, është vendosur bashkimi i procedimeve, duke u caktuar prokuror çështjeje subjekti i rivlerësimit.

i) Nga analizimi i veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, duket se ato janë zgjatur ndër vite, nga viti 2015 kur është marrë çështja nga subjekti e deri në shkurt të vitit 2021, kur është proceduar me gjykim me kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. \*\*\*/2015, në ngarkim të të pandehurit K.C , akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Vërehet se që nga viti 2015, kur procedimi është regjistruar, e deri në vitin 2018, duket se është kërkuar një informacion sporadik (siç janë kërkesat për informacion drejtuar: 1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për aplikimin e z. C si kandidat për zgjedhjet e përgjithshme; 2. Zyrës së Taksave, Zyrës së Interpolit për rekordet kriminale etj.) dhe, më tej, vërehet se në tetor të vitit 2020 denoncuesi



është regjistruar si person të cilit i atribuohet vepra penale dhe në datën 26.10.2020 është marrë në cilësinë e të pandehurit.

ii) Në lidhje me dokumentet e falsifikuara, nga analizimi i dosjes nuk del qartë se cili ishte dokumenti që ishte falsifikuar nga z. C në vitet 2008 – 2009. Dokumentet e siguruar nga hetimi nuk diktonin që z. C kishte kryer falsifikimin. Në vendim mungon arsyetimi konkret i subjektit në lidhje me falsifikimin e dokumentit nga z. C. Gjithashtu, edhe konkluzionit të subjektit se licenca e lëshuar si avokat ndaj z. C është e falsifikuar, i mungon arsyetimi.

iii) Gjithashtu vërehet se z. C ka ngritur pretendimin për çështje të moskompetencës të Prokurorisë së Rrethit Vlorë në shqyrtimin e kallëzimit, duke qenë se dokumentet e falsifikuara janë lëshuar nga një institucion me vendndodhje në Tiranë. Kjo kërkesë nuk është marrë në konsideratë.

iv) Duket se vepra penale për të cilën është akuzuar denoncuesi është parashkruar, pasi nisur nga koha e kryerjes së fakteve penale të pretenduara, e deri në regjistrimin e procedimit, kanë kaluar 6 vite. Në nenin 66 të Kodit Penal parashikohet se: *“Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë”*.

v) Në dosjen e administruar vërehen kërkesat e denoncuesit për t’u informuar në lidhje me procedurën e ndjekur për caktimin e subjektit të rivlerësimit si prokuror çështjeje, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit është emëruar prokuror i ekzekutimit të vendimeve penale që nga viti 2015 dhe, për rrjedhojë, duhej që kallëzimi të mos ndiqej nga subjekti i rivlerësimit. Kërkesa të tilla nuk kanë marrë përgjigje.

vi) Përveçse sa konstatuar në dosjen penale, Komisioni aksesoi gjithashtu edhe burimet e hapura, ku dukej se me vendimin e Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi të vitit 2016, bashkëshortja e shtetasit K.C , ish-pedagoge pranë Universitetit të \*\*\*, është shkarkuar padrejtësisht në vitin 2015, duke rezultuar ndër të tjera se po në këtë vit citohet në këtë vendim se znj. C ishte diskriminuar edhe më përpara nga ky universitet për konfliktet e saj me Bordin Drejtues, pjesë e së cilës është edhe Fakulteti i Shëndetit Publik, dekane e të cilit ishte bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Në këtë vendim, ndër të tjera, citohet pretendimi i znj.C në lidhje me shkarkimin e saj si bashkëshortja e z. C, i cili është i njohur për kallëzimet publike të bëra ndaj drejtuesve të universitetit për shpërdorim detyre. Në përfundim, referuar këtij vendimi, komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi ka urdhëruar kthimin e menjëhershëm në punë të znj. E. C.

vii) Bazuar në faktet e relatuar më sipër, duket se çështja është hetuar nga subjekti i rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit.

**22.4** Bazuar në gjetjet sa më lart, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime në lidhje me pretendimet e denoncuesit, si dhe të shpjegojë e provojë të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**22.5** Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e paraqitura ka theksuar se pretendimet e z. C janë të pabazuara dhe joligjore. Ai ka sqaruar para Komisionit se për ndjekjen e kësaj çështjeje është caktuar nga drejtuesi i Prokurorisë me vendimin për bashkimin e procedimeve datë 21.9.2016. Më tej, z. C ka paraqitur kërkesë për zëvendësimin e tij nga procedimi penal, kërkesë e cila nuk

është pranuar nga drejtuesi i prokurorisë me vendimin e datës 11.12.2020. Këtë vendim z. C e ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2021, ka vendosur pushimin e gjykimit të kësaj kërkesë.

**22.6** Subjekti ka sqaruar më tej se edhe në lidhje me pretendimin për parashkrim të veprës penale ankuesi ka marrë përgjigje me vendimin për shqyrtimin e kërkesës datë 22.1.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku ndër të tjera citohet se ky pretendim është sqaruar dhe vërtetuar nga organi procedues nëpërmjet veprimeve hetimore.

**22.7** Në lidhje me pretendimet për shortin, subjekti ka sqaruar se edhe këto nuk qëndrojnë, duke theksuar sërish se është caktuar me vendimin për bashkimin e procedimeve datë 21.9.2016. Më tej ka sqaruar se nuk e ka të ndaluar ligjërisht të hetojë çështje të tjera sipas nevojës, edhe pse ka qenë i ngarkuar kryesisht në seksionin e ekzekutimeve, pasi ndarja në seksione është mënyrë organizimi e brendshme.

**22.8** Në lidhje me pretendimin për konflikt interesi në hetimin e këtij procedimi, ka sqaruar se edhe ky fakt është i pabazuar, pasi bashkëshortja e tij, dekane e Fakultetit të Shëndetit Publik (2011 – 2016), nuk ka qenë pjesë e asnjërës prej strukturave institucionale që kanë ndjekur procedurat disiplinore të bashkëshortes së shtetasit K.C. Subjekti në përfundim paraqiti dokumentacion provues (gjithsej 12 faqe).

### **Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm**

**22.9** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e tij në kushtet e konfliktit të interesit në dukje. Pavarësisht vendimmarrjes së drejtuesit të prokurorisë, në kushtet kur bashkëshortja e subjektit si pjesë e strukturave vendimmarrëse në universitet dhe ajo e denoncuesit ishin në një konflikt që ka pasur të bëjë me marrëdhëniet e punës, nga ana e subjektit me dorëheqje do të shmangej një konflikt në dukje interesi.

Përveç sa më sipër, mungesa e vendimeve të shtyrjes, si dhe mosregjistrimi në kohë i emrit të personit të cilit i është atribuar vepra penale për 6 vjet, janë marrë në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**23. Denoncim i shtetasit S.H,** me objekt verifikimin e shkeljeve të legjislacionit në lidhje me ekzekutimin e një vendimi penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nga subjekti i rivlerësimit. Konkretisht, denoncuesi paraqitet në cilësinë e personit të interesuar për ekzekutimin e vendimit penal të sipërpërmendur, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit e konsideron të ekzekutuar vendimin penal nr. \*\*\*, datë 14.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pa kryer realisht asnjë procedurë ekzekutimi. Denoncuesi ka bashkëlidhur praktikën e ndjekur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi, si dhe aktet që lidhen me themelin e çështjes (gjithsej 83 faqe).

**23.1** Nga administrimi i akteve rezulton se me vendimin penal nr. \*\*\*, datë 14.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, denoncuesi është deklaruar fajtor për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, duke u dënuar me 6 muaj burgim, si dhe 300.000 lekë gjobë. Sipas këtij vendimi është vendosur gjithashtu të deklarohet i falsifikuar akti “shtesë kontrate”, datë 5.10.1995 dhe të urdhërohet fshirja e pjesshme e shtesave dhe ndërhyrjeve në këtë dokument (të cilat janë detajuar gjatë arsyetimit të vendimit). Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.3.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me plotësimin se në bazë të nenit 59 të

Kodit Penal të urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjithashtu, urdhërohet i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

**23.2** Vërehet se në zbatim të këtij vendimi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë nëpërmjet një prokurori tjetër ka nxjerrë urdhrin nr. \*\*\*, datë 11.6.2012, për ekzekutimin e një pjese të vendimit, atë të pagimit të shpenzimeve gjyqësore dhe të mbajtjes së kontaktit me shërbimin e provës. Në vijim, për zbatimin e pjesës tjetër të vendimit gjyqësor, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me urdhrin nr. \*\*\*, datë 22.12.2017, të subjektit të rivlerësimit, ka urdhëruar në lidhje me ekzekutimin e vendimit penal për sa i përket dokumentit të falsifikuar, me qëllim fshirjen e pjesëshme të shtesave dhe ndërhyrjeve të kryera në aktin e falsifikuar, duke ngarkuar policinë gjyqësore për zbatimin e vendimit. Në zbatim të vendimit, oficeri i policisë gjyqësore ka mbajtur procesverbal në datën 8.2.2018 për fshirjen e disa fjalëve dhe shifrave të referuara në vendimin penal të gjykatës, sipas të cilit citohet se i është vënë në dispozicion Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Vlorë për pasqyrimin e ndryshimeve. Në vijim, ASHK Vlorë (ish-ZVRPP) me shkresën e datës 20.2.2021 e informon Prokurorinë për ekzekutimin e urdhrin.

**23.3** Në përfundim të ekzekutimit, vërehet se subjekti i rivlerësimit ka njoftuar palët e interesuara, si dhe Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, pasi akti që ishte shpallur i falsifikuar lidhej me pasuri publike, me qëllim administrimin e akteve në praktikën përkatëse që lidhen me këtë çështje.

**23.4** Në lidhje me këtë çështje, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime shteruese për veprimet e ndjekura/aktet e lëshuara për ekzekutimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 14.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**23.5** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë, pasi vendimi i gjykatës është ekzekutuar plotësisht, sikurse Komisioni ka cituar në analizën e kryer në lidhje me këtë çështje dhe se me ekzekutimin e vendimit të gjykatës përfundon detyra e tij si prokuror ekzekutimi, duke paraqitur dokumentacion provues (gjithsej 11 faqe).

**23.6** Subjekti ka konkluduar se pretendimet e ankuesit lidhen me çështje të fitimit të së drejtës reale, për të cilën ankuesi mund të përdorë mjetet e duhura juridike.

### **Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave dhe e ligjit të zbatueshëm**

**23.7** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se shpjegimet e subjektit janë shteruese dhe bindëse.

### **Konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale**

**24.** Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, lidhur me analizimin e aftësive profesionale dhe denoncimet e argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se faktet e referuara dhe të analizuar më sipër në këndvështrim të përgjithshëm nuk do të ishin të mjaftueshme për të arritur në një konkluzion negativ lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, por këto fakte bazohen në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr.

84/2016, cenojnë shkallën e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLuzion PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike dhe mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe në vlerësimin tërësor ka cenuar besimin e publikut të drejtësia në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Xhemal Saliq, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 7.10.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
Kryesuese

**Pamela QIRKO**  
Relatore (kundër)

**Xhensila PINE**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*